

Syllabus i lëndës

Lënda: Stili i Shkrimit Akademik

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 4 ECTS

Niveli dhe lloji i lëndës: Zgjedhore

Kodi i lëndës: 111

Fondi i orëve: 2+2

VITI AKADEMIK :2015/2016

Semestri: -II-

Mësimdhënësi: Prof. dr. Agim Zogaj

Përshkrimi i shkurtër i lëndës:

Lënda Stili i Shkrimit Akademik e ka për qëllim përgatitjen dhe aftësimin e studentëve në procesin e të shkruarit dhe të hulumtuarit akademik si dhe mësimin e rregullave dhe metodave për shkrimin e një hulumtimi akademik. Me anën përmbajtjesore nënkuptojmë zgjedhjen e temës së punimit, pozitën dhe qëndrimin e shkencës dhe hulumtimeve të tjera të përafërta me temën e zgjedhur si dhe mangësitë në hulumtimet e deritashme të një sfare të caktuar studimore. Me anën teknike nënkuptojmë formën dhe gjatësinë e një punimi akademik , përmbajtjen e punimit, të shkruarit e citateve, burimet e citimit, fusnotat, bibliografia duke përfshirë këtu edhe punimet akademike, artikujt në gazeta, revista, libra ose përmbledhje veprash.

Qëllimi i lëndës

Me këtë plan – Program të lëndës përkatëse, studentët duhet të fitojnë njohuritë bazike nga lënda e Shkrimit Akademik dhe Metodologjisë së Hulumtimit. Ky qëllim, kryesisht do të arrihet nëpërmjet leksioneve, detyrave praktike- akademike, përkatësisht detyrave javore, atyre të kursit, debateve akademike në orët e mësimin, leximi i materialeve nga fusha e studimeve islame. Një qëllim tjetër, por jo më pak i rëndësishëm, lidhet me faktin se lënda synon që të hedhë hapat e parë ose të forcojë më tej aftësitë për të shkruar, ese akademik nga fusha e Studimeve Islame, të forcojë të menduarit akademik, mënyrat, rrugët e Metodologjisë së Hulumtimeve në rrafshin e ideve, kërkimin dhe zhvillimin e tyre. Pra, synimi është që, me këtë lëndë studentët të aftësohen për të shkruar në mënyrë akademike, për të menduar në mënyrë krijuese dhe të hapur si studiues islam.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

Të hartojë me sukses detyrat e kursit nga lënda përkatëse si dhe lëndët tjera. Pra, studentët të aftësohen për të hulumtuar, përmes shkrimit akademik në mënyrë të pavarur, duke hartuar ese akademike nga studimet përkatëse.

Të aftësohen për të konceptuar në mënyrë vetanake, shkencore, mbi bazat e shkrimit akademik dhe metodologjisë së hulumtimeve, pikëpamjet, idetë, vlerësimet mbi fushat e studimeve islame.

Të nxisë dhe të motivojë studentët për të hulumtuar format më të avancuara në fushën e shkrimit akademik, me qëllim që studentët, njohuritë e tyre t'i shndërrojnë në ese akademike, në punime kërkimore.

Metodologjia e mësimdhënies:

Kryesisht dhe në radhë të parë, do të aplikohet ligjërimi interaktiv, duke përdorur metodat më bashkëkohore të mësimdhënies, sipas shkollave perëndimore. Pra, ligjërime, mësim, përcjellje e njohurive me model interaktiv, duke sensibilizuar aktivisht dhe fuqishëm format e të menduarit të studentëve në orët e ligjëratave. Do të aplikojë edhe shembuj dhe detaje me shkrim, të drejtpërdrejt në tabelë ose në fletoret e shënimeve të studentëve dhe diskutimin akademik për fjalitë, paragrafët, esenë.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Njoftimi me Plan – programin e lëndës, objektivat akademike, qëllimet dhe metodologjinë e shtjellitimit të lëndës, përkatësisht të temave.

Java e dytë: Procesi i të shkruarit (Një historik i shkurtër mbi rëndësinë shumëdimensionale të procesit të shkruarit si formë e përcjelljes së ideve tek të tjerët...)

Java e tretë: Zhvillimi i ideve. (Leksion i ndërtuar mbi shkollat perëndimore për zbulimin e ideve, pra edhe në fushat e studimeve islame dhe zhvillimin e tyre, përmes procesit të shkrimit akademik dhe metodologjisë së hulumtimit. Pra, rruga deri te zbulimi, shtjellimi, interpretimi i ideve dhe pasqyrimi i tyre në formën e eseve akademike. Trajtim, tipik shkencor nga metodologjia e Artit të Menduarit.)

Java e katërt: Procesi i të menduarit kritik dhe të shkruarit (Ky leksion ka për synim të qartësojë se, në fakt procesi i të shkruarit është rezultat i mendimeve tona, i ndërtimit të hartës konceptuale në mendjen tonë, si rezultat i leximeve të thella dhe i hulumtimit të ideve...)

Java e pestë: Aftësitë praktike në mësim/ Leximi dhe marrja e shënimeve. (Në akademitë shqiptare, ende nuk është sqaruar sa dhe si duhet roli i leximit për përgatitjen tonë si shkruar akademik, pra mënyrat e të lexuarit efektiv, akademik. Prandaj, synimi i leksionit është që, tek studentët të sjellë qartësime të reja për rolin dhe rëndësinë leximeve të thella , studimore edhe në shkencat islame.)

Java e gjashtë: Listë për vlerësimin e situatës, para fillimit të shkrimit. (Hapi i parë para se të fillojmë të shkruajmë është përgatitja. Listimi përkatës është hap që i paraprinë përgatitjes së studentit si shkruar...).

Java e shtatë: Fillimi i procesit krijues: struktura dhe veçoritë e paragrafit. (Paragrafi, hartimi i tij strukturor është hapi i parë dhe kusht për të shkruar esetë e suksesshme. Njohuria dhe aftësimi i studentëve në këtë pikë, pra të kuptojnë rëndësinë e paragrafit në ese,

dhe aq më parë të aftësohen për të shkruar atë, është themel i suksesit në rrafshin e shkrimit akademik.)

Java e tetë: Formulimi i paragrafëve (Njoftime, zërthime teorike për mënyrat, teknikat e formimit të paragrafëve, gjithnjë sipas standardeve të ekspertëve, teoricienëve perëndimorë.)

Java e nëntë: Stili, format stilistike dhe korrektësia gramatikore (Njoftimi, shpjegimi i kuptimit dhe i rëndësisë së stilit në shkrimet akademike. Teknikat, qasjet, mënyrat më të avancuara për zhvillimin dhe avancimin e stilit në shkrimin akademik.)

Java e dhjetë: Dhjetë hapa bazë për të shkruar një ese (Hapat kryesor të cilët duhet t'i ndjekin studentët për të hartuar një ese akademike, një punim seminari, një punim diplome etj. Domsdoshmërisht duhet përkujdesur për zbatimin e rregullt të këtyre hapave konkret në fushën e shkrimeve, sepse mos zbatimi i këtyre standardeve ndikon në mungesën strukturës së shkrimeve tona. Studentëve u duhet dhënë njohuri bazike dhe të domosdoshme në këtë plan.)

Java e njëmbëdhjetë: Recensionin, Punimi i Seminarit dhe Punimi i Diplomës (Të demonstronhet teorikisht dhe praktikisht përmes modeleve të recensioneve, punimeve të seminarit si dhe punimeve të diplomës se si duket struktura e punimeve përkatëse akademike, se cila janë kornizat teorike dhe stilistike për hartimin e suksesshëm të këtyre detyrimeve akademike në rrafshin e shkrimit akademik dhe metodologjisë së hulumtimit. Ata, thjeshtë duhet të aftësohen që, të kenë dije dhe kapacitet për ta ndërtuar strukturën e një punimi akademik, të natyrës së punimit kërkimor – hulumtues.)

Java e dymbëdhjetë: Redaktimi i dorëshkrimit (Shpjegimi i mënyrave stilistike për tu aftësuar që të jemi redaktor të shkrimeve tona, që t'i mësojmë teknikat e redaktimit, sepse vetëm duke u aftësuar në cilësi të redaktorit ne do të arrijmë që, të jemi të aftë për të përmirësuar, redaktuar stilistikisht tekste tona të hartuara në fushën e hartimeve, eseve akademike të modelit të studimeve islame.)

Java e trembëdhjetë: Përdorimi i fusnotave, citateve dhe standardizimi i tyre (Njoftimi dhe aftësimi për të përdorur, pra gjatë shkrimeve akademike, kërkimore aparaturën shkencore, pra mënyrën e citimeve, shënimit e rregullt të fusnotave dhe , përgjithësisht hartimin e bibliografisë. Pa këto njohuri nga ky leksion, studentët nuk do të dinë të shkruajnë punime kërkimore hulumtues, pra as punim diplome dhe ese tjera akademike. Shpjegimi do të jetë, sipas autorëve më bashkëkohorë perëndimor.)

Java e katërbëdhjetë: Si të shkruajmë një punim / studim kërkimor – shkencor hulumtues? (Qartësimi dhe kuptimi i standardeve kryesore metodologjike për hartimin e suksesshëm të punimeve akademike, pra ndërtimin e strukturës metodologjike dhe përmbajtësore të të gjitha llojeve të punimeve shkencore. Caktimi i temës, kërkimi i ideve, leximi i literaturës dhe shtjellimi i punimit kërkimor.)

Kriteret dhe komponentët e vlerësimit:

Prezantimi dhe aktiviteti gjatë orës: **10 pikë**

Punimi seminarik: **10 pikë**

Vlerësimi i testit të parë: **20 pikë**

Vlerësimi i testit të dytë: **20 pikë**

Provimi final: **40 pike**

Literatura themelore:

1. Prof. Dr. Agim ZOGAJ, Dispensë për Shkrimin Akademik dhe Metodologjinë e Hulumtimeve, Prishtinë, 2005.
2. Bardhyl Musai, Si të shkruajmë ese, Tiranë, 2004.

Literatura plotësuese:

1. Elona Boce, Si të shkruajmë një punim kërkimor, Tiranë, 2004.
2. Studio gjithçka, arsyes vendi i parë – zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit (Grup autorësh), Tiranë, 1998.
3. Umberto Eco, Si të bëhet një punim diplome, Tiranë, 1997. Zejnullah Rrahmani, Si të shkruhet disertacioni, Prishtinë, 2001.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti është i obliguar për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve (mbahet evidenca për studentët e rregullt). Të gjithë studentët janë të obliguar t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë gjatë mësimit, ç'kyçja e telefonave celular, dhe hyrja me kohë në sallë.